# DËSHMI ARKIVI

**A-457564**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pyetjet e porositura të PD-së dhe regjia që po e bën Berishën qesharak |
| ADRESA | https://www.gazetatema.net/politika/pyetjet-e-porositura-te-pd-se-dhe-regjia-qe-po-e-ben-berishen-qesharak-i587064 |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 11:28:54 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 11:25:33 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 23b1811fd342796a71d12c393fb5e0e6c42abd3ded91cc57b47d6967b2d6f948 |
| TEKSTI | 05d76274e0872e1081a9e0716d6fe46080356a3f04e6205debfd5a97c1f648be |
| PAMJA | e80e2007b3bafd7e09512614f9ee425b4f7d309d662a1bb0c3ed84d40b2ff138 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 631f90978cb847f0db5f3b24e9147dc2fd0e78361e5a4b745d4d8158a562f59d |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | d62161966812e333892ed1a12b4b718f8d0962907bcb93c104eb3485a382e6f9 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/631f90978cb847f0db5f3b24e9147dc2fd0e78361e5a4b745d4d8158a562f59d

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Pyetjet e porositura të PD-së dhe regjia që po e bën Berishën qesharak

TemA

19 Shtator 2026, 13:25Politika TEMA



Sali Berisha doli sot sërish në bashkëbisedim me ndjekësit në rrjetet sociale dhe, për herë të shtatë brenda javës, u tregoi shqiptarëve për takimet e tij në SHBA.

Në të njëjtën dalje, ai akuzoi SPAK-un se i shërben Edi Ramës dhe e paraqiti kryeministrin si të tmerruar nga mundësia e një përballjeje me drejtësinë.

Por momenti më domethënës nuk ishte as sulmi ndaj SPAK-ut, as rrëfimi i radhës për Amerikën. Ishte një pyetje nga "ndjekësja" Greta Beqiri.

Me pak vëmendje, rezulton se zonja Beqiri nuk është thjesht një qytetare që pyet nga rrjetet sociale, por punonjëse e zyrës së shtypit të PD-së, personi që shpërndan njoftimet e partisë në grupet e gazetarëve.

Pyetjet e porositura nuk janë risi në politikën shqiptare. I bëjnë të gjithë: kryeministra, kryetarë partish, ministra e deputetë. Por edhe propaganda kërkon pak kujdes. Edhe teatri kërkon pak regji.

Në rastin e PD-së, duket se as kjo nuk është bërë dot. Floriana Garo dhe ekipi i komunikimit mund të kishin gjetur të paktën një emër anonim, në vend që pyetjen "nga qytetarët" t'ia porosisnin zyrës së shtypit.

Kjo nuk flet për pazotësinë e Berishës në komunikim. Përkundrazi, ai ka qenë për dekada një nga politikanët më të aftë për të dominuar skenën publike.

Por sot duket i rrethuar nga njerëz kaq të paaftë, sa çdo dalje që duhet ta ndihmojë, përfundon duke e bërë qesharak.

Kur pyetjet "spontane" vijnë nga zyra e shtypit, problemi nuk është më vetëm mesazhi. Problemi është regjia./Vna

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Parlamenti Europian mbështet Shqipërinë: Hapa të shpejtë drejt anëtarësimit në BE]

12:35 Politika

“Pse Berisha s’e mori të shoqen në SHBA?”, Rada: Ja çfarë po ndodh me Aeroportin e Vlorës!

09:57 Politika / 7 komente

[Tabaku: Familjet shqiptare mbyllin muajin me borxh, ndërsa korrupsioni rëndon koston e jetesës (VIDEO)]

09:49 Politika / 17 komente

["Prania Besnike", zbardhen raportimet nga qarqet/ Qindra ankesa të mbledhura, Rama: Procesi duhet të vijojë sipas objektivave]

08:45 Politika / 12 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.